



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:228170

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05805025

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci , në çështjen penale kundër të akuzuarve F. S. nga Gjakova për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe të akuzuarve Y.S., E.S. dhe E. S. që të tre nga Gjakova për shkak të veprës penale Pengimi i personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në bashkëkryerje nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/IL.nr.1386/2023 të datës 30.11.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 05.06.2024 , në prani të Prokurorit të shtetit Shqiponja Jupa , mbrojtësit të akuzuarin Besnik Haxhijanuzi , sipas detyrës zyrtar, mbrojtësit të akuzuarit Y.S. av. Rexhep Gjokolli sipas detyrës zyrtare , mbrojtësit të akuzuarës E.S. av. Urim Pozhegu sipas detyrës zyrtare, mbrojtësit të akuzuarit F. S. a av. Avdi Rizvanolli sipas detyrës zyrtare , mbrojtësit të akuzuarit E. S. av Agim Haraqija sipas autorizimit , dhe të akuzuarve , me datë **07.06.2024**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **F. S.** , nga Gjakova , data e lindjes . . . , i biri Y. dhe i nënës E. e gjinisë M. , ka të kryer shkollën fillore , elektrikist , i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar , atë i 1 fëmije, shqiptar, shtetas i R. Kosovës me ,ID . . . . .

I akuzuari **Y. S.**, nga Gjakova, data e lindjes . . . . i biri B dhe i nënës N e gjinisë R , ka të kryer shkollën e mesme ,i papunë , i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar , atë i 3 fëmijëve, shqiptar, shtetas i R. Kosovës , me ID. . .

E akuzuara **E. M.**, nga Gjakova Rr. “. . , data e lindjes . . . , e bija e A dhe e nënës S e gjinisë E , ka të kryer shkollën e mesme ,e papunë , i gjendjes së dobët ekonomike, e martuar , nënë e 3 fëmijëve, shqiptare, shtetase e R. Kosovës , me ID. . . . .

I akuzuari **E.S.**, nga Gjakova Rr.. . . , data e lindjes . . . , i biri Y. dhe i nënës E. e gjinisë M. , ka të kryer shkollën fillore , kamerier , i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, shqiptar, shtetas i R. Kosovës me ,ID . . .

**I. I akuzuari F. S.;**

**Ë s h t ë F a j t o r**

## Sepse:

- Me dt.18.09.2023 rreth orës 19:45, në rr. “. . .” K.Gjakovë, seriozisht e kanos se do te e privoj nga jeta zyrtarin policor-të dëmtuarin Sh. S., në atë mënyre që ditën kritike pasi i dëmtuari Sh. S. se bashku me zyrtarin policor S. P.- këtu dëshmitar, në zbatim të detyrave të tyre te punës e ndalojnë automjetin me tabela . . .me shofer Y. S.-këtu dëshmitar, ku ky i fundit urdhërohet t'i largojë tabelat e veturës pasi që vetura nuk kishte regjistrim, e aty vjen i pandehuri F. S. dhe nëna e tij E.S.-këtu dëshmitare, e cila fillon t'i afrohet të dëmtuarit S., e ku ky i fundit kërkon qe ajo të largohet, ku në ato çaste i pandehuri F. S. i drejtohet te dëmtuarit Sh. S. me fjalët '**Kush kari je ti me mi bërtite nanës time, t 'kalli, t'vraj'**,

-me çka ka kryer vepër penale '**Kanosja**' nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 2,3, 4, 6, 7, 17, 38, 39 par. 1. nën par. 1.2, neneve 46 par. 1 nën par. 1.1 dhe par. 2 nën par. 2.2, nenit 47, 48, 49, 50, , 69, 70, 71 par. 1 nën par.1.1dhe . 1.3 , 72 par 1 nën. par.1.6 nenit 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së , nenit 364 të KPP-së , të akuzuarin F. S. e :

## G J Y K O N

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **120( njëqind e njëzet ) ditësh** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1( një) viti** , nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

I dëmtuari Sh. S. nga Gjakova ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## II. Të akuzuarit Y.S.,E. M. dhe E. S. ;

### J a n ë F a j t o r

## Sepse:

- Me dt.18.09.2023 rreth orës 19:45, në rr. 'Gasper Krasniqi' K.Gjakovë, në bashkëkryerje me përdorim të forcës pengojnë personat zyrtar në kryerjen e detyrave të tyre të punës dhe atë zyrtarëve policor të dëmtuarve Sh. S. dhe S. P., në atë mënyre që kur zyrtarët policor fillojnë arrestimin e F. S.-këtu dëshmitar, të pandehurit Y., E. dhe E. S. me përdorim te forcës i shtyjnë dhe i kapin për duar zyrtarët policor, e po ashtu iu drejtohen me fjalët '**Nuk keni me e arrestu, nuk keni me e kap**', te gjitha këto me qëllim qe të pamundësojnë arrestimin e F. S., ku si pasojë e këtyre veprimeve te dëmtuarit Sh. S. dhe S. P. kanë pësuar lëndime trupore,

-me çka në bashkëkryerje kane kryer vepër penale '**Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare**' nga neni 401 par. 5 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 2,3, 4, 6, 7, 17, 38, 39 par. 1. nën par. 1.2, neneve 46 par. 1 nën par. 1.1 dhe par. 2 nën par. 2.2, nenit 47, 48, 49, 50, , 69, 70, 71 par. 1 nën

par.1.1dhe . 1.3 , 72 par 1 nën. par.1.5, nenit 401 par. 5 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nenit 364 të KPP-së , të akuzuarit i :

## GJYKON

Të akuzuarin **Y. S.;**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **180( njëqind e tetëdhjetë ) ditësh** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1( një) vit** , nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

Të akuzuarën **E.M. ;**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **180( njëqind e tetëdhjetë ) ditësh** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1( një) viti** , nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

Të akuzuarin **E.S.;**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **180( njëqind e tetëdhjetë ) ditësh** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1( një) viti** , nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

Të dëmtuarit Sh. S. dhe S. P. nga Gjakova ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë shpenzimet në shumë prej nga 20.00 €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 20.00 €, në afat prej 15 ditëve , pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën , PP/II.nr.1386/2023 të datës 30.11.2023 të pranuar në gjykatë me datë 01.12.2023, ka akuzuarin F. S. nga Gjakova për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe të akuzuarve Y. S., E.S. dhe E. S., që të tre nga Gjakova për shkak të veprës penale Pengimi i personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në bashkëkryerje nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori e shtetit Shqiponja Jupa , gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 05.06.2024 pas leximit të aktakuzës aktakuzën PP/II.nr.1386/2023 të datës 30.11.2023 deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I pandehuri F. S., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë j deklaron e pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Besnik Haxhijanuzi, thekson se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë deklaron: se ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem sipas aktakuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë , shtoj se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt ,premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet ne te ardhmen duke i kërkuar falje publike të dëmtuarve ,andaj gjykatës i propozoi qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , kërkim falje publike, gjendjen e dobët ekonomike, me parë nuk kam qenë i dënuar per ndonjë vepër penale te me shqiptojë një dënim me te butë .

Mbrojtësi i te akuzuarit av. Besnik Haxhijanuzi deklaroi se në tërësi pajtohem me deklarimi e te mbrojturit tim per pranim te fajësisë , për çka kërkojmë nga gjykata qe pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë tejet lehtësuese me rastin e caktimit dhe llojit te lartësisë se dënimit .Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se sa i përket rrethanave lidhur me vendimin për dënimin i propozoi gjykatës qe konform dispozitave te kodit te procedurës penale ,me qe është bere pranimi i fajësisë ,te merren për bazë te gjitha benefitet qe rrjedhin nga dispozitat ligjore .

E pandehura E. M. ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaron e pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Urim Pozhegu , thekson se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe e njëjta lidhur me fajësinë deklaron: se ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem sipas aktakuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë , shtoj se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt pasi qe edhe sjelljet e zy. policor nuk kanë qenë ne nivel te duhur ,premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet ne te ardhmen duke i kërkuar falje publike të dëmtuarve ,andaj gjykatës i propozoi qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , kërkim falje publike, gjendjen e dobët ekonomike, me parë nuk kam qenë e dënuar për ndonjë vepër penale te me shqiptojë një dënim me te butë .

Mbrojtësi i te akuzuarit av. Urim Pozhegu deklaroi se dakordohem me pranimin e fajësisë nga ana e te mbrojturës sime ,pranimi i fajësisë ky qe ka ardhur pas konsultimeve te mjaftueshme me mua si mbrojtëse, andaj gjykatës i propozoi qe te aprovojë pranimin e fajësisë si te sinqertë dhe te vullnetshëm e assesi si një beneficion te cilën e ofron ligji ne mënyrë formale. Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se i bashkëngjitem deklarimeve te kolegut paraprak , shtojë se gjykata duhet e merr parasysh me rastin e caktimi te llojit dhe matjes se dënimit ,veprimin e te mbrojturës sime si instinkt i nënës për mbrojtë te fëmijës, që është rrethanë posaçërisht lehtësuese ne raport me rrethanat tjera renduese ne këtë çështje .

I pandehuri Y. S., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaron e pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Rexhep Gjokolli , thekson se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë deklaron: se ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem sipas aktakuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë , shtoj se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt ,premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet ne te ardhmen duke i kërkuar falje publike të dëmtuarve ,andaj gjykatës i propozoi qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , kërkim falje publike, gjendjen e dobët ekonomike, me parë nuk kam qenë i dënuar për ndonjë vepër penale te me shqiptojë një dënim me te butë .

Mbrojtësi i te akuzuarit av. Rexhep Gjokolli ,deklaroi se në tërësi pajtohem me deklarimi e te mbrojturit tim per pranim te fajësisë , për çka kërkojmë nga gjykata qe pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë tejet lehtësuese me rastin e caktimit dhe llojit te lartësisë se dënimit . Lidhur me vendimin për dënimit i propozoi gjykatës qe konform dispozitave te kodit te procedurës penale ,me qe është bere pranimi i fajësisë ,te merren për bazë te gjitha benefitet qe rrjedhin nga dispozitat ligjore si dhe shtojë se te merren parasysh edhe sjelljet e zy. policor ditën kritike te cilat nuk kanë qenë ne nivelin e duhur ndaj këtu te pandehurve .

I pandehuri E. S., ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi e pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Agim Haraqija, thekson se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë deklaroi: se ndihem fajtor për veprën penale me te cilën pandehem sipas aktakuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë , shtoj se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt ,premtoj se një veprim i tillë nuk do te përsëritet ne te ardhmen duke i kërkuar falje publike të dëmtuarve ,andaj gjykatës i propozoi qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se një veprim i tillë nuk do te përsëritet , kërkim falje publike, gjendjen e dobët ekonomike, me parë nuk kam qenë i dënuar për ndonjë vepër penale te me shqiptojë një dënim me te butë .

Mbrojtësi i te akuzuarit av. Agim Haraqija deklaroi se në tërësi pajtohem me deklarimi e te mbrojturit tim për pranim te fajësisë , për çka paraprakisht jemi konsultuar me te pandehurin duke e njoftuar me te gjitha benefitet dhe pasojat e pranimit te fajësisë, për çka edhe e pranojë fajësinë gjatë këtij shqyrtimi , propozoi gjykatës qe te aprovojë pranimin e fajësisë . Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se sa i përket rrethanave lidhur me vendimin për dënimit i propozoi gjykatës qe konform dispozitave te kodit te procedurës penale ,me qe është bere pranimi i fajësisë ,te merren për bazë te gjitha benefitet qe rrjedhin nga dispozitat ligjore .

Prokurori i shtetit Shqiponja Jupa , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë te bere nga ana e te akuzuarve , për shkak se pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurve është bere sipas kualifikimit ligjor qe u lexua sot ne shqyrtim fillestar , është i ligjshëm dhe ne përputhje me te gjitha kushtet ligjor qe i parasheh KPPK, lidhur me këtë institut , e sidomos faktin se te pandehurit janë konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësi te tyre te cilët janë prezent ne këtë seancë .Andaj ,prokuroria konsideron se pranimi i fajësisë është bere në përputhje me te gjitha provat dhe shkresat e lendes , e te cilat prova janë prova te ligjshme dhe fajësuese në këtë çështje penale. Andaj gjykatës i rekomandojë qe te aprovojë pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve .Lidhur me vendimin për dënimin deklaroi se me rastin e caktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit i propozoi gjykatës qe ne këtë çështje penale te merr si rrethanë renduese ne raport me te pandehurin Y. S., E.S. dhe E. S., shkallen e lartë te pjesëmarrjes se te pandehurave në vepër penale ,rrethanë kjo e nenit 70/2 pika 2.1 te KPP-ës, duke u bazuar ne gjendje faktike te përshkruar si ne diapozitiv te aktakuze, provat e kësaj çështje penale, e me theks te veçantë ne bazë te provave materiale CD me video incizim, ku shihet kontinuiteti i veprimeve te pandehurve ne kryerjen e kësaj vepre penale . Po ashtu si rrethanë renduese ndaj e pandehurit F. S. i propozoi gjykatës qe te merr parasysh shkallen e lart te dashjes nga i pandehuri , rrethanë kjo e nga neni 70/2.2 te KPP-ës, ku shkalla e lartë e dashjes rezulton nga përshkrimi i gjendjes faktike te përshkruar si ne dispozitiv te aktakuze, ku i pandehuri dy here radhazi përdor fjale kanosëse ndaj te dëmtuarit , me çka absorbon shkallen e lart te dashjes ne veprimin e tij. Ndërsa si rrethanë lehtësues te merret parasysh pranimi i fejeje nga te pandehurit ne këtë seancë gjatë shqyrtimit fillestar, Po ashtu gjykatës i propozoj te pandehurit te obligohen ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarve, është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike: se i akuzuari F. S. me veprimet e tij me dashje ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së ndërsa të akuzuarit Y.S., E.S. dhe E. S., në bashkëkryerje me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale Pengimi i personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në bashkëkryerje nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së., në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në diapozitivin e këtij Aktgjykimi.

## 4. Elementet e veprës penale

Sipas nenit 181par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Kanosje e kryen :” *Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj*”.

Në par. 2 është parashikuar se: “ *Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. 3.*

Ndërsa në par. 3 të po këtij neni është parashikuar se :”*Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Sipas nenit 401 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare e kryen : “*. Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.*

Në par. “*Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet*”.

Në par. 3. “*Udhëheqësi apo organizatori i grupit që kryen veprë penale nga paragrafi 2. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.* “

Në par 4. *Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni përfshin kanosjen për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm ose rezulton me lëndim trupor, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Ndërsa si formë më e rëndë e kësaj vepre është paraparë në par. 5 të këtij neni i cili parasheh se : *Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria zyrtarit policor, zyrtarit doganor, zyrtarit ushtarak apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.*

#### 5. Vendimet e gjykatës

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarit , i ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohen sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit F. S. formohen të gjitha elementet e veprës penale Kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur me par.2 të KPRK-së ndërsa me veprimet e të akuzuarve Y.S., E.S. dhe E. S., në bashkëkryerje formohen të gjitha elementet e veprës penale në bashkëkryerje Pengimi i personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në bashkëkryerje nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , prandaj për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 dhe 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarit konstaton faktin se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të përshkruara si në dispozitivat e këtij aktgjykimi si dhe fakti se nga Evidenca penale e kësaj gjykate i akuzuari F. S. evidentohet me këto lënd penale Pnr. – 478/2020 - neni 269, Dënim me gjobë 100 euro, i PF 08.02.2021 dhe PKR – 38/2021 – neni 269, Denim kusht 12 muaj për 2 vite, dhe dënim me gjobë 200 euro i PF 21.10.201r ,ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve se të akuzuarit Y.S.dhe E. M. janë prindër të tre fëmijëve ndërsa i akuzuari F atë 1 fëmije , moshën relativisht të re të akuzuarve F dhe E. S. , të akuzuarit tjerë nga Evidenca penale e gjykatës rezulton se nuk ka lende me dënime penale në evidencën penale të personave të dënuar, gjendjen e tyre të dobët ekonomike , sjelljen tejet korrekte në gjykim, të, janë penduar thellë për veprën penale të kryer, kërkim falja nga të dëmtuarit . Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në shqyrtimin fillestar ,shprehjen e keq ardhjes për veprimet e tyre në afekt , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , të cilat rrethana ndikuan që për të akuzuarit gjykata në rastin konkret ti aplikoj kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 72 par.1 nën. par.1.5 dhe 1.6 të KPRK-së , kur iu ka shqiptuar dënimin me burgim nën minimumin ligjor si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 47 të i KPRK-së, me bindje se ky dënim të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi e shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimit të ligjit

#### 7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarit Sh. S. dhe S.P., i për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishëm të kërkesës pasurore juridike,

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor u murr në bazë të nenit 450 par.1dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së , ndërsa vendimi mbi pagimin e shumës prej nga 20.00 euro , u murr konform nenit 39 paragraf 3 nën paragraf 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P.nr.2023:228170 më datë 07.06.2024**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes se tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate